



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS

MINISTRI

Rruga e Durrësit, Nr. 23, Tiranë

Tel/fax 04 223002

Nr. 8937 Prot.

MIRATOHET

MINISTRI

GENC POLLO

RREGULLORE

PËR SHKOLLAT QË FITOJNË STATUSIN "SHKOLLA TË NIVELIT KOMBËTAR"

1. Statusin "Shkolla të nivelit kombëtar" e marrin shkollat e mesme teknike, profesionale dhe social kulturore, të cilat kanë cilësitë e mëposhme:
 - a. Kanë infrastrukturë të përshtatshme për të siguruar një cilësi të lartë të mësimin teorik dhe të praktikës profesionale, duke shërbyer si model për shkollat e tjera homologe të vendit;
 - b. Kanë më shumë se 400 nxënës ose janë të vetme në llojin e vet në rang vendi;
 - c. Kanë kushte të nevojshme dhe mundësi për pranimin në to të nxënësve nga rrethet e ndryshme të vendit; kanë konvikte, ku sigurohen kushte normale jetese dhe studimi për nxënësit e ardhur nga rrethet e tjera;
 - d. Kanë personel mësimor të kualifikuar dhe mund të organizojnë vetë ose në bashkëpunim me institucione të tjera veprimtari kualifikuese për mësuesit e lëndëve të specialitetit ose mësuesit e praktikave profesionale të shkollës së tyre dhe të shkollave të tjera homologe;
 - e. Kanë rezultate të mira në punën me nxënësit për t'i bërë ata të aftë për një profesion ose veprimtari të caktuar dhe për integrimin social të tyre;
 - f. Kanë potencialin e nevojshëm për t'u siguruar nxënësve kompetencat e domosdoshme profesionale për t'u punësuar,
 - g. Kanë rezultate cilësore për zhvillimin e personalitetit të nxënësve, për edukimin

